



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë
Me datë: 10.07.2021

Vendimet për TEMAT MASTER						
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni		Vendimi
1	Kosovare Pajaziti	P.Sh.P	Niveli i përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe të nxëniet në Shkollat e Mesme Profesionale	Kryetar/e	Kastriot Buza	Miratohet
				Mentor/e	Sylejman Berisha	
				Anetar/e	Hatixhe Ismajli	
2	Erlindë Mehmeti	P.Sh.P	Përfshirja e Gjinisë Femërore në Shkolla Profesionale	Kryetar/e	Demë Hoti	Miratohet
				Mentor/e	Sylejman Berisha	
				Anetar/e	Bahtije Gërbeshi	
3	Shkelqesë Osmanaj	E.I	Shkolla gjithëpërfshirëse kundrejt qendrës burimore në zhvillimin akademik dhe socio-emocional të fëmijëve me nevoja të veçanta	Kryetar/e	Ardita Devolli	Miratohet
				Mentor/e	Naser Zabeli	
				Anetar/e	Arlinda Beka	
4	Argonita Thaci	E.I	Qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me ndikimin e klasave të bashkangjitura në procesin e integritetit të nxënësve me nevoja të veçanta	Kryetar/e	Blerim Saqipi	Miratohet
				Mentor/e	Naser Zabeli	
				Anetar/e	Ardita Devolli	
5	Have Haxhiaj		Ndikimi i standardeve të komunikimit efektiv në menaxhimin e shkollës	Kryetar/e	Ganimete Kulinxha	Miratohet
				Mentor/e	Zeqir Veselaj	
				Anetar/e	Vlora Sylaj	

KOSOVARE PAJAZITI

Titulli: “Niveli i përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe të nxënimit në Shkollat e Mesme Profesionale”

Komisioni:

1. Prof. Asoc. Dr. Sylejman Berisha – mentor
2. Prof. Ass. Dr. Kastriot Buza – kryetare
3. Prof. Ass. Dr. Hatixhe Ismajli – anëtare

ABSTRAKT

Në vendet e zhvilluara Shkollat profesionale janë synim i shumë nxënësve të cilët përfundojnë klasën e nëntë për arsyeje të perspektivës që kanë ato. Kurse në Kosovë shkollat profesionale për fat të keq nuk e kanë këtë privilegj.

Shkollat profesionale në krahasim me shkollat tjera pa dyshim se i kanë kërkesat më të mëdha dhe me të kushtueshme në infrastrukturë, laborator të ndryshëm, material harxhues etj., kjo është një sfidë për Kosovën si një shtet jo i zhvilluar. Përdorimi i TIK-ut në çdo sferë të jetës sot është bërë një domosdoshmëri jetike në të gjithë botën, në të njëjtën kohë edhe konstatimet e shumë hulumtimeve të bëra nga hulumtues të ndryshëm për të mirat që i sjellë përdorimi i TIK-ut në klasë, ka ndikuar dhe shtuar nevojën që shkollat profesionale të kanë kërkesa më të mëdha për tu pajisur me TIK dhe infrastrukturë përcjellëse,

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të matim nivelin e përdorimit të TIK-ut në Shkollat e Mesme Profesionale (ShMP), sa janë të furnizuara ShMP., me pajisje të TIK-ut, dhe a janë të përgatitur mësimdhënësit në përdorimin e TIK-ut në klasa.

Për ta nxjerrë një rezultat të mirë dhe të saktë ky hulumtim kërkonte një qasje sasimore dhe cilësore, mundë të themi një qasje të përzier. Ndërsa, instrumentet që janë përdorur në këtë hulumtim janë pyetësorët si dhe intervistat gjysmë të strukturuar.

Mostrat e këtij hulumtimi janë: drejtorët, mësimdhënësit dhe nxënësit e dy nga shkollat e mesme profesionale në komunën e Viti-së dhe një në Gjilan.

Ky hulumtim është realizuar duke u bazuar në këto dy pyetjet hulumtuese se: “A janë mjaftueshëm të pajisura Shkollat e Mesme Profesionale me pajisje të TIK-ut?” dhe “Cili është niveli i përdorimit të pajisjeve të TIK-ut që janë në dispozicion nëpër Shkollat e Mesme Profesionale?”, dhe hipoteza e shtruar është: “*Niveli i përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe të nxënimit në Shkollat e Mesme Profesionale nuk është i kënaqshëm*”.

Nga rezultatet e dalura në këtë hulumtim mund të konstatojmë se niveli i përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie dhe të nxënimit në ShMP., nuk është i kënaqshëm, për arsyeje të mungesës së pajisjeve të TIK-ut nëpër klasë, dhe kabinete, si dhe mungesa e trajnimeve për të gjithë mësimdhënësit për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie, këto rezultate na bëjnë të mundur edhe vlefshmërinë e hipotezës së shtruar.

Fjalët kyçe: mësimdhënia, të nxënimit, mënyrat, trajnimet, TIK, niveli i përdorimit të TIK-ut.

ERLINDË MEHMETI

Tema: “Përfshirja e Gjinisë Femërore në Shkolla Profesionale”

Komisioni:

1. Prof. Asoc. Dr. Sylejman Berisha – mentor
2. Prof. Ass. Dr. Demë Hoti– kryetar
3. Prof. Ass. Dr. Bahtije Gërbeshi – anëtare

ABSTRAKT

Arsimi profesional është çelësi që hap derën për të hyrë në botën e punës dhe ekonomisë, redukton varfërinë e përmirëson cilësinë e jetës; njëherit është rruga më efikase për të depërtuar nga shkolla në tregun e punës.

Mungesa e femrave në arsimin profesional sot, ndikon në pjesëmarrjen e femrave në tregun e punës nesër. E pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është element i rëndësishëm për të kuptuar natyrën dhe suksesin e trajektores së zhvillimit ekonomik të një vendi.

Prandaj, punimi fokusohet te pjesëmarrja e gjinisë femërore në arsimin profesional; përkatësisht, identifikimi dhe analizimi i dallimeve gjinore në arsimin profesional, si dhe tendencat e zhvillimit të tyre paraqet qëllimin e hulumtimit, kurse rëndësia e tij qëndron në atë se eksploron faktorët “pengues” të përfshirjes së femrave në këtë lloj arsimi, duke venë theksin te mundësitë që u ofrohen atyre.

Është konsideruar se studimi e arrinë qëllimin e tij nëse marrim përgjigje në pyetjet e parashtruara: “Sa janë të përfshira femrat në shkolla profesionale?”; “A nxiten/mbështeten mjaftueshëm femrat që të ndjekin mësimet në shkolla profesionale?”; “Cilët janë faktorët pengues në pjesëmarrjen e femrave në shkolla profesionale?”; si dhe të vërtetojmë hipotezen: “Pjesëmarrja e femrave në shkolla profesionale është relativisht e ulët.”

Për të përmbushur qëllimin e këtij hulumtimi nëpërmjet modelit konvergjent paralel, janë mbledhur, analizuar e interpretuar të dhënat e mbledhura nga tri burime: nxënësit (semimaturantë dhe maturantë), mësimdhënësit e shkollave (fillore dhe profesionale), si dhe drejtorët e shkollave (fillore dhe profesionale).

Nga rezultatet e këtij hulumtimi shohim se nxënësit kanë mungesë informacionesh lidhur me orientimin e tyre për karrierë, gjinisë femërore nuk u ofrohen mundësi të mjaftueshme për pjesëmarrje në arsimin profesional, e faktorë të tjerë pengues.

Fjalët kyçe: *Arsim dhe Aftësim Profesional, karriera, faktorë pengues, stereotipe gjinore, tregu i punës.*

SHKELQESË OSMANAJ

TEMA: “Shkolla gjithëpërfshirëse kundrejt qendrës burimore në zhvillimin akademik dhe socio-emocional të fëmijëve me nevoja të veçanta”

Komisioni:

1. Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli, mentor
2. Prof.As. Ardita Devolli, kryetar,
3. Prof. As. Arlinda Beka, anetar

ABSTRAKTI

Në sistemin arsimor të Kosovës për rreth 15 vite me radhë ishte dhe është çështje diskutimi gjithëpërfshirja, thënë më mirë përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkolla dhe klasa të rregullta. Krahas shkollave gjithëpërfshirëse që pranojnë nxënësit me nevoja të veçanta, në sistemin tonë arsimor hyjnë edhe qendrat burimore të cilat përfshijnë vetëm nxënës me nevoja të veçanta. Shkollat e rregullta dhe qendrat burimore mundësojnë që të gjithë nxënësit e përfshirë të zhvillohen maksimalisht në të gjitha aspektet. Mirëpo, përderisa nxënësit me nevoja të veçanta po u nënshtrohen dy mundësive për arsimim, atëherë çështje e rëndësishme është të hulumtojmë dhe të arrijmë të kuptojmë se cila nga këto dy institucione arsimore zhvillon më shumë aspektin akademik dhe socio-emocional të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Ky studim i titulluar “*Shkolla gjithëpërfshirëse kundrejt qendrës burimore në zhvillimin akademik dhe socio-emocional të fëmijëve me nevoja të veçanta*” ka për qëllim që të vlerësojë shkallën e zhvillimit akademik dhe socio-emocional të nxënësve në shkollë gjithëpërfshirëse dhe ta krahasojë me qendrën burimore si dhe të vlerësojë llojin e vështirësive të shkollës gjithëpërfshirëse në plotësimin e këtyre nevojave. Pra, me anë të këtij hulumtimi përmes pyetjes sonë të hulumtimit ne synojmë të dimë se cila nga këto dy institucione plotëson më shumë nevojat e nxënësve në këto dy aspekte.

Popullatë e këtij studimi janë 100 mësime të nxënësve me nevoja të veçanta të shkollës/klasës gjithëpërfshirëse dhe 20 mësime të nxënësve me nevoja të veçanta të qendrës burimore. Si instrumente kryesore u hartuan dy pyetësorë të veçantë për secilin grup të pjesëmarrësve. Me anë të këtij studimi ne arritëm në përfundim se nxënësit me nevoja të veçanta në aspektin akademik dhe socio-emocional zhvillohen më shumë në shkollë gjithëpërfshirëse se në qendër burimore.

FJALË KYÇE: *qendër burimore, shkollë gjithëpërfshirëse, vështirësitë, zhvillim akademik, zhvillim socio-emocional.*

AGRONITA THAÇI

Tema: “Qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me ndikimin e klasave të bashkangjitura në procesin e integritit të nxënësve me nevoja të veçanta”

Komisioni:

1. Prof. Asoc. Dr. Naser Zabeli, mentor
2. Prof.As. Blerim Saqipi, kryetar,
3. Prof. As. Ardita Devolli, anetar

ABSTRAKTI

Ndikimi i klasave të bashkangjitura ndikon në integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollën fillore, sepse ai trajton diversitetin si një pasuri që ndihmon përgatisin individë për jetë dhe qytetari aktive në gjithnjë e më komplekse, kërkuese, multikulturore dhe shoqëri të integruara.

Klasat e bashkangjitura janë hapur nga viti 2002 në Kosovë me qëllim të rritjes së përfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor dhe mbështetjes së nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin e rregullt. Ideja e hapjes se këtyre klasave ishte që të ofrohen mundësi më të mëdha për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, duke hyrë në arsim të rregullt përmes klasave të bashkangjitura dhe pastaj fëmijët gradualisht të integrohen në klasa të rregullta në shkollat më të afërta. Për momentin klasat e bashkangjitura janë klasë të mbyllura me nivel të ultë të bashkëpunimit me klasat e rregullta.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të pasqyrojë ndikimin e klasave të bashkangjitura në integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në klasat e rregullta.

Problemi që do e studioj i përket aspektit kuantitativ dhe për realizimin e këtij hulumtimi, do të përdorim pyetësorët. Mostra që kemi përzgjedhur përfshin 100 mësimdhënës të rregullt, 10 mësimdhënës mbështetës dhe 100 prindër në disa nga shkollat fillore të mesme të ulëta që kanë klasë të bashkangjitura si në komunën e Rahovecit, Gjakovës, Klinës dhe Prishtinës.

Nga ky hulumtim kemi arritur në këto përfundime se qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me ndikimin në klasat e bashkangjitura në procesin e integritit të nxënësve me nevoja të veçanta janë për inkuadrimit apo integrimin e nxënësve në klasat e bashkangjitura, por nëse në ato klasa ka edhe mësimdhënës mbështetës të cilët do të ndihmojnë mësimdhënësit e rregullt.

Rezultatet e këtij studimi do të shërbejnë gjithashtu për të ndërgjegjësuar komunitetin shkollor për një vizion më të qartë dhe më pranues të nxënësve me nevoja të veçanta nga klasat e bashkangjitura në klasat e rregullta në shkollën fillore.

Fjalë kyçe: *mbështetje, nxënës nevoja të veçanta arsimore, klasë të bashkangjitura, shkolla të rregullta, mësimdhënës udhëtues, mësimdhënës përfshirës.*

HAVE HAXHIAJ

Tema: “Ndikimi i standardeve të komunikimit efektiv në menaxhimin e shkollës”

Komisioni:

1. Prof. ass. dr. Ganimet Kulinxha- kryetare
2. Prof. asoc. Dr. Zeqir Veselaj- mentor
3. Prof. ass. dr. Vlora Sylaj – anëtare

ABSTRAKT

Të fillojmë të mendojmë për jetën në përgjithësi nuk do të mund të ndalemi kurrë me sfidat dhe mundësinë e të qenit njeri. Në përgjithësi njerëzit e ndryshëm në kohë të ndryshme kanë vështirësi të ndryshme. Para këtyre vështirësive njerëzit dorëzohen pa u ndalur së menduari për të zgjidhur, zbutur dhe luftuar problemin. Mirëpo, mirësia e jetës vjen me të bukurat e saj edhe në rastet me probleme. Dëshira dhe njëkohësisht nevoja që të njoh më shumë ndikimin që ka komunikimi në menaxhimin e shkollës dhe duke e parë si një çështje mjaft delikate e njëkohësisht shumë të rëndësishme ishin arsyet kryesore të këtij punimi. Komunikimi brenda shkollës dhe për interesat e shkollës bëhet në mënyra të ndryshme, varësisht nga përmbajtja dhe nga ata që komunikojnë. Cilësia e komunikimit përcakton cilësinë e jetës sonë të përditshme, ashtu edhe në vende të punës, e në këtë rast, në shkollë. Çdo situatë komunikuese ka për synim arritjen e një rezultati dhe si do të jetë ai rezultat, varet nga personat që bëjnë pjesë në këto procese të komunikimit. Një komunikim efektiv është atëherë kur të tjerët e kuptojnë mesazhin që ua transmetojmë. Komunikimi në nivel shkolle pasqyron gjendjen e shkollës, përparësitë dhe dobësitë e saj, përvojat pozitive dhe negative, detyrat dhe përgjegjësitë, sukseset dhe mosesukseset, të arriturat dhe performancën. Arritja e suksesit në shkollë varet shumë nga aftësitë komunikuese me mësimdhënësit brenda dhe jashtë shkollës. Ky hulumtim synon që të nxjerrë në pah rolin që kanë standardet e komunikimit në përmirësimin e mësimdhënies dhe të nxënies, si dhe në tërë procesin e edukimit të nxënësve nëpërmjet partneritetit udhëheqës-mësimdhënës. Pra, përmes këtij hulumtimi ne kemi për qëllim të vërtetojmë ndikimin e komunikimit efektiv në menaxhimin e shkollës, duke përfshirë SHFMU “Ndre Mjeda”- Rakosh, SHFMU “Bajram Curri”- Istog, SHFMU “3 Dëshmorët e Shkollës Shqipe”- Uçë, shkolla këto të cilat gjenden në komunën e Istogut. Metoda e përzgjedhur për të mbledhur të dhënat e nevojshme për këtë hulumtim ishte metoda e analizës cilësore dhe sasiore, e cila u realizua përmes pyetësorit dhe intervistës gjysmë të strukturuar me mësimdhënësit dhe drejtorët e këtyre shkollave.

Fjalët kyçe: *cilësia, komunikimi, menaxhimi, standardet, shkolla.*